



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ANDI F. RIZAJ
ADRESA NR.10, KONT URANI, NR.51
TEL: 694001353



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 4661

Nr. koleksioni: 995

Tirane më 27/11/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2020053310089724185

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBETARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

Nr. 9661 Rep.

Nr. 995 Kol.



KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Në Tiranë, sot në datë 27 Nentor 2020 (dymijë e njëzet), përpara meje noterit publik Andi F. Rizaj, i regjistruar në Dhomën e Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale me adresë Rruga “Kont Urani”nr.51, u paraqitën personalisht shtetasit:

Ioannis Maleas, shtetas grek, i datëlindjes **26.11.1949**, identifikuar me pasaportën me nr. AM508224, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, referuar mëposhtë si Shitësi;

dhe

Gëzim Norja, shtetas shqiptar, i lindur në Knete, Durrës, i datëlindjes 03.03.1964, identifikuar me letërnjoftimin ID nr personal G40303106T, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, referuar mëposhtë si Blerësi.

Palët e mësipërme me vullnet të lirë dhe të plotë, kërkuan nga unë noteri hartimin e kësaj kontrate shitje aksionesh, më përmbajtje si mëposhtë:

Kushtet Paraprake:

Z. Ioannis Maleas është aksioner dhe zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë “AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA SHA”, shoqëri tregtare e së drejtës Shqiptare, e regjistruar pranë QKB me Nipt. L11408003V, me kapital 3.500.000Lekë, të barabartë me 100 aksione, me vlerë nominale 35.000Lekë për aksion.

Z. Ioannis Maleas dëshiron të shesë pjesërisht aksionet e zotëruara në shoqëri, konkretisht në masën 50% të tyre, që përbëjnë 50% të kapitalit të shoqërisë, me çmim shitje 1.750.000Lekë (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë).

Z. Gëzim Norja, deklaron se dëshiron ti blejë Z. Ioannis Maleas 50% të aksioneve të zotëruara prej tij në shoqëri, pra 50% të kapitalit të shoqërisë të barabartë me 50 aksione/pjesë të zotëruara në shoqëri me çmim blerje 1.750.000 Lekë (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë).

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të shoqërisë “AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA” SHA nëpërmjet Vendimit të datës 27.11.2020 ka vendosur: Miratimin e transferimit të 50% të aksioneve që aksioneri Z. Ioannis Maleas zotëron në shoqëri, në favor të aksionerit të ri Z. Gëzim Norja kundrejt çmimit 1.750.000Lekë, të barabartë me 50 aksione me vlerë nominale 35.000Lekë/aksioni.

Neni 1
Qëllimi i kontratës

Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi i pronësisë së aksioneve, që përbëjnë 50% të kapitalit të shoqërisë nga shitësi te blerësi.

Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së transferimit të pronësisë dhe pagesës përkatëse lidhur më këtë transferim.

Në përcaktim të kushteve, palët konsiderojnë të ligjshme përmbajtjen e saj dhe marrin përsipër të ekzekutojnë veprimet e tyre brenda kushteve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 2
Objekti i kontratës

Nëpërmjet kësaj kontrate, shitësi transferon në favor të blerësit pjesërisht aksionet e zotëruara në shoqëri, në masën 50 % të kapitalit të saj, të barabartë me 50 aksione sipas çmimit të përcaktuar në nenin 3 mëposhtë.

Blerësi do të blejë nga shitësi 50% të aksioneve të zotëruara nga ai në shoqëri, të cilat përbëjnë 50 % të kapitalit të saj, të barabartë me 50 aksione, sipas çmimit të përcaktuar në nenin 3.

Neni 3
Çmimi dhe mënyra e pagimit

Palët kanë dakordësuar që çmimi i shitjes së 50% të aksioneve që shitësi zotëron në shoqëri është *1.750.000 Lekë (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë)*.

Po ashtu, palët deklarojnë se shuma e mësipërme prej *1.750.000 Lekë (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë)*, i është shlyer tërësisht Palës shitëse nga ana e Palës blerëse përpara nënshkrimit të kësaj kontrate jashtë zyrës noteriale dhe se nuk kanë asnjë pretendim financiar kundrejt njëri tjetrit.

Neni 4
Përgjegjësitë dhe garancitë e palëve

Shitësi nëpërmjet kësaj kontrate shitje aksionesh garanton si mëposhtë :

- i. Se është i vetmi titullar i ligjshëm i aksioneve që po transferohen me këtë kontratë shitje aksionesh;
- ii. Se aksionet objekt shitje janë plotësisht të lira nga çdo barrë, detyrim, apo çfarëdo lloj kufizimi tjetër.
- iii. Se transferimi i këtyre aksioneve tek blerësi është bërë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e statutit të Shoqërisë.





Neni 5

Efektet e kontratës

Kjo kontratë ka fuqinë e ligjit për palët që nga momenti i nënshkrimit të saj përpara noterit dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim dypalëshe.

Kontrata ka efekt për palët e treta në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 6

Informacioni konfidencial

Palët detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe çdo informacion të përfituar gjatë marrëdhënies se tyre në shoqëri apo marrëdhënies konkrete të krijuar me këtë kontratë.

Neni 7

Transferimi i të drejtave

Menjëherë pas nënshkrimit të palëve, kontrata do të depozitohet dhe regjistrohet nga blerësi pranë QKB duke mundësuar kështu transferimin e aksioneve tek blerësi i ri.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësi zhvishet nga pronësia mbi 50 % të kapitalit të shoqërisë, i barabartë me 50 aksione dhe nga çdo e drejtë tjetër mbi to, dhe zotërues i tyre bëhet blerësi Z.Gëzim Norja.

Neni 8

Interpretimi i kontates

Nëse do të jetë e nevojshme të bëhet interpretimi i kësaj kontrate, do të synohet të përcaktohet se kush ka qenë qëllimi real dhe i përbashkët i të dyja palëve, pa u mbështetur në kuptimin literal të fjalëve, dhe gjithashtu duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, përpara dhe pas përfundimit të kësaj kontrate.

Kushtet e kesaj kontrate do te interpretohen njera pas tjetres, duke dhënë secila kuptimin qe rrjedh nga tërësia e kontratës në fjalë.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

Kontrata është hartuar në përputhje me përcaktimet e nenit 6 e vijues të statutit të Shoqërisë "AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA" SHA dhe legjislacionin tregtar në fuqi.

Blerësi dhe Shitësi angazhohen të bëjnë çdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të mundshme që mund të krijohen midis tyre, lidhur me këtë kontratë nëpërmjet negociimeve të drejtëpërdrejta.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të mundshme midis tyre, ato do të zgjidhen në baze marrëveshjeve dhe procedurave gjyqësore në fuqi sipas Legjislacionit Shqiptar.

Në çdo rast gjykata kompetente për zgjidhjen e konflikteve gjyqësore do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.




Kjo kontratë është hartuar në 4(katër) kopje, me vlerë të njëjtë ligjore nga një për secilën palë dhe ju lexua më zë të lartë e të qartë palëve nga unë noteri.

Palët deklaruan se e dëgjuan, kuptuan dhe meqenëse e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, ju perkthye nga perkthyesja e gjuhes greke Aleksandra Gjoni mbajtese e kartes ID nr.F05412102R e nënshkruan personalisht dhe pa vërejtje përpara meje noterit.

Pas nënshkrimit të palëve, unë noteri e nënshkrova dhe e vërtetova kontratën sipas përcaktimeve të ligjit "Për Noterinë".


SHITËSI

MANEAS. 
IOANNIS.

BLËRËSI




Perkthyes





NOTER







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI AKSIONARE”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L11408003V			
2. Data e Regjistrimit	08/02/2011			
3. Emri i Subjektit	AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA			
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare			
5. Data e themelimit	26/01/2011			
6. Kohëzgjatja	Nga: 26/01/2011 Deri:			
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative nr.11, Rruga Dritan Hoxha, ndertesa nr.98, 1026, hyrja.1			
8. Kapitali	3.500.000,00			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	2000000.0000			
10. Numri i aksioneve:	100,00			
10.1 Vlera nominale:	35.000,00			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejte vote	pa të drejte vote
11.1 Numri për secilën kategori				
12. Objekti i aktivitetit:	Ne fushen e nxjerrjes dhe perpunimit te materialeve te para dhe minerare.Germim,nxjerrje,perpunim,prodhim dhe tregtim te gureve te fraksionuar.Eksplorim,germim,hapje,shfrytezim minerash dhe aktivite te tjera minerare.Perdorim i lendeve plasese dhe			



REPUBLIKA
ANAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	eksplozive ne objekte infrastikturore,ndertimore,germime dhe aktivitete minerare.Germim dhe perpunim i dherave dhe mbetjeve industriale dhe urbane dhe riciklimi i tyre.Prodhim e perpunimi i materialeve qe perdoren per ndertim.Ne fushen e tregtise dhe te karakterit te pergjithshem.Import dhe eksport te inerteve dhe materialeve te tjera qe perdoren ne ndertim.Import,eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice materialeve te ndertimit,brenda dhe jashte vendit,per llogari te veta apo te te treteve.Import,eksport,qiradhenie dhe leasing i linjave teknologji,pajisje,makinerive apo linjave te prodhimit.Ne fushen e ndertimeve,ne zbatim perfshin aktivitete si me poshte.Ndertimin e objekteve civile dhe industriale dhe ndertimi i veprave te ndryshme publike etj	
13. Sistemi i administrimit	<input type="checkbox"/> me një nivel <input checked="" type="checkbox"/> me dy nivele	
14. Administratori/ët	Gëzim Norja	
14.1 Afati i emërimit	Nga : 17/05/2019	Deri : 17/06/2022
15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka).		
16. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës(plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Ioannis Mafeas	
16.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
16.2 Afati i emërimit	Nga : 25/07/2019	Deri : 25/07/2022
17. Anëtar i Pavarur	Po	
17.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Jo	
17.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
18. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
19. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës(plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Daniela Doko	
19.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
19.2 Afati i emërimit	Nga : 25/07/2019	Deri : 25/07/2022
20. Anëtar i Pavarur	Po	
20.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Jo	
20.2 Kushtet e pjesëmarrjes		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

21. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
22. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Lulzim Hilaj
22.1 Kryetar/anëtar	Anetar
22.2 Afati i emërimit	Nga : 25/07/2019 Deri : 25/07/2022
23. Anëtar i Pavarur	Po
23.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	Jo
23.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
24. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
25. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar	H Auditing
25.1 Afati i emërimit	Nga : 21/03/2019 Deri :
26. Aksionarët	IOANNIS MALEAS
26.1 Numri i Aksioneve	Me te drejte vote : 100.0000 Pa te drejte vote :
26.2 Përqindja e pjesëmarrjes	100.00
27. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Lezhe Mamurras MAMURRAS Bashkia Mamurras, Mamurras, Perroi i Karabashit
28. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: AVRANOS ENTERPRISES ALBANIA E-Mail: danieladoko@hotmail.com Telefon: 0694017696
29. Statusi:	Aktiv

Datë : 27/11/2020

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)